



# **VLERËSIMI DHE ORIENTIMI I POTENCIALEVE TË INICIATIVËS “BALLKANI I HAPUR”**

**PROGRESI NË ZVOGËLIMIN E HENDEKUT ADMINISTRATIV TË  
INICIATIVËS SË BALLKANIT TË HAPUR NË FUSHËN E AKSESIT TË  
LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR:  
QËNDRIMI I KOMUNITETIT TË BIZNESIT**

**Versioni final**

---

**Qendra për Analiza Ekonomike - QAE**

Maj 2024, Shkup

**Projekti:** VLERËSIMI DHE ORIENTIMI I POTENCIALEVE TË INICIATIVËS “BALLKANI I HAPUR”

**Zbatuar nga:** Qendra për Analiza Ekonomike - QAE Shkup

**Titulli:** PROGRESI NË ZVOGËLIMIN E HENDEKUT ADMINISTRATIV TË INICIATIVËS SË BALLKANIT TË HAPUR NË FUSHËN E AKSESIT TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR: QËNDRIMI I KOMUNITETIT TË BIZNESIT

**Autorë:** Ekspertët nga vendet (sipas rendit alfabetik):  
Shqipëri: Merita Toska  
Bosnja dhe Hercegovina: Adnan Çerimagiq  
Kosovë: Qendra për Studime të Avancuara Ekonomike  
Mali i Zi: Instituti për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik  
Maqedonia e Veriut: Qendra për Analiza Ekonomike dhe Stefan Ristovski  
Serbia: Qendra për Studime të Avancuara Ekonomike

Punimi i këtij studimi është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur nëpërmjet Projektit “Vlerësimi dhe orientimi i potencialeve të iniciativës “Ballkani i Hapur”” zbatuar nga QAE. Qëndrimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Shoqëria e Hapur.

Riprodhimi lejohet për qëllime jo tregtare me kusht që të citimin e burimit të informacionit.

## Përmbajtja

<b>Rreth projektit</b> .....	4
<b>Konteksti</b> .....	5
<b>Hyrje</b> .....	8
<b>Përgatitja e një liste me rekomandime nga këndvështrimi i komunitetit të biznesit</b> .....	8
Metodologjia .....	8
Qëndrime lidhur me legjislacionin dhe rekomandime .....	9
Përfundime .....	11
Qëndrimet në lidhje me përmirësimet e procedurave, personelit dhe pajisjeve .....	12
Përfundime .....	14
Lidhur me legjislacionin .....	16
Lidhur me procedurat .....	17
<b>Nevoja e mundshme për një forum rajonal biznesi në lidhje me aksesin e lirë në tregun e punës dhe/ose nevojën për një forum rajonal biznesi në lidhje me iniciativën e Ballkanit të Hapur në përgjithësi</b> .....	17
Metodologjia .....	17
Analizë .....	18
Konkluzione .....	23
Të përgjithshme .....	23
Sipas shtetit .....	24

# Rreth projektit

**QENDRA PËR ANALIZA EKONOMIKE - QAE ZBATON NJË PROJEKT NJË VJETOR TË FSHH ME TITULLIN:**

**VLERËSIMI DHE ORIENTIMI I POTENCIALEVE TË INICIATIVËS “BALLKANI I HAPUR” (IBH).**

## KONTEKSTI

Duke kuptuar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor në lidhje me uljen e interesit për zgjerim nga BE-ja, presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq, kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev dhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama morën një vendim në tetor të vitit 2019 "për të marrë fatin e tyre në duart e veta" dhe ngritën idenë e krijimit të një "mini Schengen". Në korrik të vitit 2021, kjo ide u shndërrua në një iniciativë rajonale "**Ballkani i Hapur**<sup>1</sup>". Iniciativa nuk është një zëvendësim i anëtarësimit në BE, por një rrugë për anëtarësimin e përsheptuar dhe shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese, por të pashfrytëzuara në këto vende, të cilat mund të nxisin rritjen dhe zhvillimin ekonomik më tej dhe rrjedhimisht përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

## SFIDAT PËR TË RUAJTUR MOMENTUMIN

Për zhvillimin dhe kujdesin e marrëdhëniesve fqinjësore në Ballkanin Perëndimor me qëllim rritjen e prosperitetit ekonomik, është e nevojshme të hiqen kontrollet kufitare dhe barrierat e tjera për të lehtësuar qarkullimin e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe kapitalit në rajon. Analiza e dallimeve sipas rajoneve (për shembull rajonet bregdetare kundrejt tokësore, NNJTS 2 dhe NNJTS 3, urbane kundrejt rurale, kryeqytetet kundrejt qyteteve të tjera) për vendet e Ballkanit të Hapur mund të japë përgjigje në lidhje me prioritetet për rritjen e përsheptuar dhe afrimin e brendshëm të rsajonit të Ballkanit të Hapur. **Aktualisht nuk ka një analizë të shtjelluar siç duhet për të vlerësuar sfidat ekzistuese.**

Përvoja me pandeminë Covid-19, kriza ushqimore dhe energjetike, si dhe lufta në Ukrainë theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të brendshëm, si dhe nevojën për mirëkuptim dhe solidaritet të ndërsjellë midis vendeve të Ballkanit të Hapur. Koordinimi dhe bashkëpunimi i brendshëm, shkëmbimi i përvojave dhe solidariteti që vendet e rajonit i ofrojnë njëri-tjetrit sjellin vlerë të shtuar në drejtim të integritetit të ardhshëm në BE, nëse vendet e Ballkanit të Hapur flasin me një zë.

Mjedisi i jashtëm i rajonit, veçanërisht tani për shkak të luftës në Ukrainë, e thekson edhe më shumë se sa i rëndësishëm është bashkëpunimi dhe koordinimi, si dhe nevojën për mirëkuptim dhe solidaritet të ndërsjellë.

## MJETET DHE INSTRUMENTET PËR VLERËSIMIN E POTENCIALIVE PËR REALIZIMIN E BASHKËPUNIMIT DHE KORDINIMIT

Ndërsa në planin politik vullneti politik tregohet në nivelin më të lartë për Ballkanin e Hapur, ende në nivelin administrativ, d.m.th. njerëzit "në terren" nuk mund t'i ndjejnë ende përfitimet e kësaj nisme. **Ajo që mungon, për të mos thënë më së paku, është hulumtimi i politikave të bazuara në dëshmi mbi bllokimin e bashkëpunimit midis potencialeve të gjashtë shteteve të Ballkanit të Hapur.**

---

<sup>1</sup> Me nismën e Ballkanit të Hapur, ne do të përcaktojmë territoret e gjashtë vendeve nga Ballkani Perëndimor-BP6: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia.

## AKTIVITETET NË KUADËR TË PROJEKTIT

Një grup ekspertësh të pavarur nga gjashtë vendet të cilët do të punojnë në diagnostikimin dhe hulumtimin pengesave në bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjet vendeve të Ballkanit të Hapur, do t'i shtojnë vlerë vullnetit politik tashmë të demonstruar që nisma e Ballkanit të Hapur të zhvillohet në një mënyrë më të strukturuar dhe sistematike duke iu referuar prioriteteve të rrugës së zhvillimit të kësaj nisme rajonale.

## Konteksti

Sipas kushteve të projektit, ky projekt kërkimor rajonal ka katër detyra kryesore (të gjitha informacionet dhe dokumentet janë të disponueshme këtu: <https://cea.org.mk/proekt-otsenka-i-nasochuvane-napotentsijalite-na-initsijativata-otvoren-balkan/>):

- DETYRA 1: Analizat e vendeve – rishikim i nismës Ballkani i Hapur
- DETYRA 2: Analiza e pabarazive rajonale
- DETYRA 3: Vlerësimi i boshllëqeve administrative dhe pengesave
- DETYRA 4: ProjekSIONET makroekonomike për Ballkanin e Hapur

**Thelbi i DETYRËS 1** lidhej me faktin se pothuajse çdo nismë politike mund të zbatohet, por qëllimi përfundimtar i çdo nisme politike duhet të jetë përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve. Pra, ideja dhe vullneti politik në lidhje me Ballkanin e Hapur në një farë mënyre duhet të transmetohet vertikalisht nga politikanët në pushtet (ekzekutiv-qeveri dhe legjislativ-kuvendi) përmes administratës me instrumente si: takime, seanca, strategji, plane veprimi, programe dhe të ngjashme dhe zbatimi i tyre për qytetarët, pra për përfitime më të mëdha për qytetarët. Shikoni më shumë në linkun e mëposhtëm: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1.-OBI-Project-Regional-Report\\_Task-Final\\_NAJFINAL-CIP29052023.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1.-OBI-Project-Regional-Report_Task-Final_NAJFINAL-CIP29052023.pdf).

**Thelbi i DETYRËS 2** lidhej me faktin se secili nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) ka karakteristikat e veta, pra brenda vendeve dhe mes tyre ka dallime, por edhe ngjashmëri. Prandaj, ne analizojmë ndryshimet dhe ngjashmëritë e Nomenklaturës së Njësisve Territoriale për Statistikat 3 (NNJTS 3) në nivel të rajoneve të BE-së, në varësi të disponueshmërisë së të dhënave. Ideja është që duke pasur parasysh Memorandumet e Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet në lidhje me iniciativën e BH dhe Lirinë e Lëvizjes së BE-së, disa rajone të NNJTS në vendet BP6 mund të kenë më shumë ngjashmëri me njëri-tjetrin sesa të tjerët. Kështu, ato rajone NNJTS 3 që formojnë një grup të caktuar, për shembull shfaqin ngjashmëri për sa i përket karakteristikave të caktuara demografike dhe/ose karakteristikave të caktuara socio-ekonomike, mund të jenë një platformë për zbatimin më efektiv të Lirisë së Lëvizjes së BE-së dhe objektivave të memorandumeve të Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet lidhur me nismën e BH. Kjo nuk do të thotë se rajonet me pabarazi më të mëdha nuk mund të arrijnë të njëjtat qëllime, por vetëm tregon se politikat në rajonet me ngjashmëri më të madhe mund të zbatohen në mënyrë më efektive sepse kanë sfida të ngjashme. Në rajonet ku pabarazitë më të mëdha janë të dukshme, ka të ngjarë të nevojiten më shumë burime për të arritur konvergencën dhe për të reduktuar pabarazinë. Shikoni më shumë në linkun e mëposhtëm: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1.1.-VOL-1-Report-Disparity-Analysis\\_withCIP12062023N.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1.1.-VOL-1-Report-Disparity-Analysis_withCIP12062023N.pdf). Po ashtu edhe te: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/2.1.-VOL-2-Report-Task-2-Economic-view-of-disparities\\_withCIP12062023N.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/2.1.-VOL-2-Report-Task-2-Economic-view-of-disparities_withCIP12062023N.pdf), si edhe te: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/3.1.-VOL-3-Report-Task-2-Cluster-analysis\\_withCIP12062023N.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/3.1.-VOL-3-Report-Task-2-Cluster-analysis_withCIP12062023N.pdf).

**Thelbi i DETYRËS 3** ishte të shqyrtonte faktet dhe të vlerësonte potencialin e administratës për të zbatuar iniciativat. Në këtë seksion, ne kemi identifikuar një Marrëveshje në lidhje me nismën e Ballkanit të Hapur,

për të cilën është kryer një verifikim faktesh dhe janë përgatitur rekomandime me një listë ndryshimesh të mundshme ligjore.

Duke marrë parasysh burimet e projektit, ne identifikuam *Marrëveshja për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në kuadër të IBH (nëse kjo Marrëveshje hyn në fuqi, zbatimi i saj do të fillojë në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të qytetarëve të BP-së)*. Kjo Marrëveshje u theksua edhe si më e rëndësishmja për punën në terren të komunitetit të biznesit në diskutimet në Shkup dhe Beograd.

Ne kemi zhvilluar një mjet për të vlerësuar nëse vendet pjesëmarrëse në nismën e BH kanë zhvilluar/miratuuar/krijuar akte nënligjore, protokolle ose instrumente të tjera të përshkruara në Memorandumet e Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet në lidhje me nismën e BH. Në fund, për të verifikuar faktet e zbatimit të Marrëveshjes së identifikuar në kuadër të iniciativës së BH-së, ekspertët nga gjashtë vendet vlerësuan boshllëkun administrativ dhe dhanë rekomandime në lidhje me listën e amendamenteve të mundshme ligjore. Kështu, DETYRA 3 përbëhet nga sa vijon:

1. Takim pune me komunitetin e biznesit në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi për të zbuluar këndvështrimin e tyre për rëndësinë relative të Memorandumeve të Mirëkuptimit dhe Marrëveshjeve në kuadër të iniciativës së BH (vendet pjesëmarrëse dhe jo pjesëmarrëse);
2. Implementimi i një mjeti për të vlerësuar nëse vendet pjesëmarrëse në kuadër të iniciativës së BH kanë zhvilluar/miratuuar/krijuar akte nënligjore, protokolle ose instrumente të tjera të përshkruara në Memorandumet e Mirëkuptimit dhe Marrëveshjet në lidhje me iniciativën e BH (vetëm vendet pjesëmarrëse);
3. Identifikimi dhe mbledhja e evidencave në lidhje me zbatimin *Marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës*, në kuadër të iniciativës BH, dhe përgatitja e rekomandimeve me listën e ndryshimeve të mundshme ligjore (vendet pjesëmarrëse dhe jo pjesëmarrëse).

Shikoni më shumë në linkun e mëposhtëm: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1-Report-Task-3-administrative-gap-assessment-labor-market-access\\_FINAL\\_publish-1.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1-Report-Task-3-administrative-gap-assessment-labor-market-access_FINAL_publish-1.pdf).

**Thelbi i DETYRËS 4** ishte të hetonte përfitimet/humbjet ekonomike të pjesëmarrjes/mospjesëmarrjes në nismën e Ballkanit të Hapur për vendet e Ballkanit Perëndimor, individualisht dhe si grup (rajon) me integrim të plotë dhe të pjesshëm, në kundërshtim me procesin e Berlinit, përmes prizmit të një projekcioni afatgjatë të treguesve kryesorë makroekonomikë. Ky dokument paraqet detaje të supozimeve në bazë të skenarëve dhe rezultateve. Tre skenarë u vlerësuan dhe u analizuan dhe u prezantuan rezultatet:

1. Vetëm tre vende (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) janë pjesë e nismës së BH-së;
2. Të gjashtë vendet e BP bëhen anëtarë të nismës së BH-së;
3. Iniciativa e Ballkanit të Hapur u përkthye në procesin e Berlinit.

Shikoni më shumë në linkun e mëposhtëm: [https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1-Report-Task-4-Macromodelling\\_ENG-1.pdf](https://cea.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/1-Report-Task-4-Macromodelling_ENG-1.pdf).

**SHËNIM I RËNDËSISHËM:** Ekspertët sipas vendeve kishin një qëndrim neutral dhe një qasje të paanshme në lidhje me mbledhjen dhe analizën e të dhënave brenda kësaj detyre kërkimore. Pavarësisht nga qëndrimi i dikujt ndaj iniciativës së BH-së, qoftë kritika e informuar apo mbështetja për iniciativën, opinioni i tyre nuk duhet të ndikojë në procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave në mënyrë që të mos favorizojë, injorojë ose inkurajojë një përgjigje ose rezultat të caktuar kundrejt të tjerëve.

Vendet nga Ballkani Perëndimor që janë pjesë e nismës BH (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) përcaktohen në këtë dokument si **“pjesëmarrëse”**, kurse vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë pjesë

e iniciativës BH (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi) përcaktohen në këtë dokument si vende **“jo pjesëmarrëse”**.

# Hyrje

Në shtatorin e vitit 2023, në kuadër të Detyrës 3, ne organizuam një takim pune me komunitetin e biznesit në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi për të mbledhur pikëpamjet dhe perceptimin e bizneseve mbi rëndësinë relative të Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruar në kuadër të iniciativës së BH dhe vetë iniciativës BH dhe përgatitëm një raport përkatës.

## **Qëllimi i këtij dokumenti të iniciativës Ballkani i Hapur është përmbushja e dy qëllimeve:**

- 1. Përgatitja e një liste me rekomandime nga këndvështrimi i komunitetit të biznesit në lidhje me aksesin e lirë në tregun e punës.**
- 2. Mbledhjen e perceptimeve dhe vlerësimit të komunitetit të biznesit për nevojën e një forumi rajonal të biznesit në lidhje me aksesin e lirë në tregun e punës dhe/ose nevojën për një forum rajonal biznesi në lidhje me nismën e Ballkanit të Hapur në përgjithësi.**

## **Ne e zbatojmë këtë në kuadër të kësaj Detyre Përfundimtare të konceptit të përgjithshëm të projektit.**

**Shtjellimi:** Në janar 2024, dy protokolle të reja nën iniciativën Ballkani i Hapur u nënshkruan nga liderët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për të lehtësuar situatën e tregut të punës. Ky dokument përmbledh mësimet e bizneseve në këto tre vende për zbatimin e këtyre protokolleve dhe për nismën e Ballkanit të Hapur në përgjithësi.

**Nën-aktivitetet:** Qendra për Analiza Ekonomike përgatiti përshkrimin e detyrave dhe metodologjinë, kontratat dhe koordinoi ekspertët e vendeve. Hapi tjetër është përkthimi i këtij raporti në gjuhën shqipe, serbe dhe maqedonase dhe më pas do të shpërndahet në faqet e internetit të organizatave që janë përfshirë në këtë projekt.

Më tej në tekst tregohet përmbledhja e analizës së gjetjeve sipas raporteve të ekspertëve për vendet.

# Përgatitja e një liste me rekomandime nga këndvështrimi i komunitetit të biznesit

## **Ekspertët nga vendet pjesëmarrëse dhe jo-pjesëmarrëse të nismës Ballkani i Hapur ndërморën aktivitetet për këtë qëllim.**

### Metodologjia

Për objektivin e parë në lidhje me përgatitjen e një liste me pikëpamje dhe rekomandime të strukturuar nga komuniteti i biznesit, ekspertët:

- Shqyrtuan dokumentin që u përgatit në shtatorin e vitit të mëparshëm: Vlerësimi strategjik i situatës aktuale, ashtu si ishte planifikuar me nismën Ballkani i Hapur dhe përcaktimi i hendeut administrativ për marrëveshjen për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.
- Shqyrtimin e raportit për vendin që ekspertët kanë përgatitur vitin e kaluar;
- Përgatitjen e përgjigjeve për pyetjet e mëposhtme duke punuar së bashku me komunitetin e biznesit:



- Cilat janë pengesat në lidhje me zbatimin e (nën) legjislacionit për aksesin e lirë në tregun e punës (për t'u përgatitur për ndërveprim me përfaqësues nga komuniteti i biznesit, merrni parasysh tabelën 2 për vendin tuaj nga dokumenti i përgatitur në shtator 2023.: <https://cea.org.mk/tsea-studija-otvoren-balkan-i-administrativniot-jaz-za-dogovorot-za-sloboden-pristap-do-pazarot-na-trudot/>)
- Cilat janë pengesat në lidhje me zbatimin e procedurave, mungesat e personelit dhe pajisjeve për akses të lirë në tregun e punës (për t'u përgatitur për ndërveprim me përfaqësues nga komuniteti i biznesit, rishikoni Tabelën 3 për vendin tuaj nga dokumenti i përgatitur në shtator të vitit 2023: <https://cea.org.mk/tsea-studija-otvoren-balkan-i-administrativniot-jaz-za-dogovorot-za-sloboden-pristap-do-pazarot-na-trudot/>)

Më poshtë janë vlerësimet për arritjen e këtij objekti të parë.

### Qëndrime lidhur me legjislacionin dhe rekomandime

Ju paraqesim një përmbledhje të vlerësimit të ekspertëve në tabelën e mëposhtme <sup>2</sup>.

SHTETI	QËNDRIMET QË LIDHEN ME LEGJISLACIONIN	REKOMANDIME QË LIDHEN ME LEGJISLACIONIN
Shqipëria	<p>Për sa i përket përbajtjes, komuniteti i biznesit nuk është i informuar mirë për zhvillimet në lidhje me nismën e Ballkanit të Hapur, veçanërisht në lidhje me tregun e lirë të punës. Edhe pse Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë fillimisht ishte e përfshirë në procesin e nënshkrimit të memorandumëve, ajo nuk arriti të përcjellë një informacion të tillë tek komuniteti i biznesit dhe të nxisë interesin e tyre.</p> <p>Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit nuk tregojnë interes të veçantë për iniciativën, pavarësisht nga madhësia, pozicioni i tyre në treg dhe ndikimi që ata kanë. Në vend të kësaj, ata kryesisht e shohin iniciativën si një çështje politike, jo si diçka gna e cila mund të përfitojë komuniteti i biznesit.</p> <p>Gjithashtu, të huajt që janë të punësuar në Shqipëri duhet të menaxhojnë personalisht të gjithë dokumentacionin dhe procesin për t'u kualifikuar për punësim, ndërkohë që kompania në fjalë nuk ka asnjë angazhim në këtë drejtim.</p>	<p>Përmirësimi i transmetimit vertikal të informacionit nga administrata dhe shoqata e biznesit tek operatorët.</p> <p>Paraqitja e nismës Ballkani i Hapur si nismë socio-ekonomike, jo si nismë politike.</p> <p>Operatorët duhet të ndihmojnë punëtorët e interesuar në procesin e mbledhjes së dokumentacionit dhe përmbushjes së kërkesave administrative.</p> <p>Procedurat e thjeshtuara përfshijnë pranimin e formularit të aplikimit për leje pune me garanci (financiare dhe juridike) të kompanisë që punëson personin përkatës (Ligji për të Huajt, që rregullon hyrjen, qëndrimin dhe punën e të huajve në Republikën e Shqipërisë).</p>
Bosnja dhe Hercegovina	<p>Nuk ka dallim mes qytetarëve të Ballkanit Perëndimor dhe të huajve të tjerë.</p> <p>Së pari duhet të kontrollohen të gjitha pozicionet për punëtorët nga jashtë për të përcaktuar nëse ka qytetarë të papunë</p>	<p>Asnjë problem i menjëhershëm nuk është identifikuar për momentin.</p> <p>Shënim: Edhe nëse vetë kuotat nuk janë pengesa kryesore, nëse vendoset trajtimi preferencial për Ballkanin Perëndimor dhe/ose procedurat thjeshtohen, kërkesa për kuota do të rritet.</p>

<sup>2</sup> Tabelat e detajuara të ofruara nga ekspertët janë të disponueshme në raportet e veçanta të vendeve.

	<p>të BeH që mund të pranojnë pozicionin e punës.</p> <p>Kuotat për punësimin e të huajve vendosen në nivel shtetëror.</p>	
Kosova *	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
Mali i Zi	<p>Ligji duhet të ndryshohet dhe të jetë më pak kufizues për të huajt që vijnë për të punuar në vend.</p> <p>Sipas punëdhënësve, të dhënat e personave të papunë në Mal të Zi nuk janë të përshtatshme. Një kuotë më e lartë për punësimin e të huajve do të miratohej nëse rekordi i papunësisë do të ishte më realist.</p> <p>Si kufizim kryesor, punëdhënësit përmendin burokracinë, dokumentacionin e gjerë, mungesën e një sistemi elektronik për raportimin e të huajve, kontrollet e gjata të sigurisë nga MPB-ja, por edhe qasjen e pabarabartë të zyrtarëve të caktuar ndaj të huajve në komuna të ndryshme.</p>	<p>Në përgjithësi, procedura e punësimit të të huajve gjatë marrjes së lejes së punës duhet të thjeshtohet dhe standardizohet.</p> <p>Futja e kategorisë së punëtorëve sezonalë të përhershëm.</p>
Maqedonia e Veriut	<p>Aktet nënligjore duhet të thjeshtohen dhe harmonizohen me legjislacionin e BE-së.</p> <p>Mundësisht, në vend të përditësimit të ligjeve ekzistuese, të hartohet një ligj i ri që do të përfshijë përjashtimet dhe statusin preferencial të punonjësve nga rajoni i BP - në përputhje me kërkesat e nevojshme të BE-së.</p>	<p>Procedurat administrative që janë ekskluzive vetëm për fuqinë punëtore që vjen nga vendet në kuadër të nismës Ballkani i Hapur - duhet të shqyrtohen qartë se si do të rregullohen këto përjashtime - për të mos shkaktuar probleme.</p> <p>Marrëveshjet dypalëshe (me Shqipërinë dhe Serbinë) duhet të përshtaten dhe përditësohen për të pasqyruar marrëveshjen dhe protokollin për lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore në lidhje me iniciativën Ballkan i Hapur.</p> <p>Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet vendeve dallojnë (MK-ALB dhe MK-SRB) për sa i përket shtrirjes së të drejtave sociale të të huajve që janë të punësuar në shtet. Duhet t'i kushtohet vëmendje harmonizimit/riekzaminimit dhe verifikimit të përputhshmërisë me ligjin e BE-së dhe nismën e Ballkanit të Hapur.</p>
Serbia	Sipas bizneseve të anketuara, korniza legjislative nuk është e përshtatshme për akses të lirë në tregun e punës në rajon (Ligji për të Huajt dhe Ligji për Punësimin e të Huajve).	<p>Ulje e taksave për banesat me qira për punëtorët e huaj.</p> <p>Bashkë me ligjet duhet të paraqesin leje pune afatgjatë dhe disa përfitime shtesë punësimi për punëtorët nga vendet e Ballkanit Perëndimor që të vendosin të vijnë për të punuar në vendin tonë.</p>

Marrë nga raportet e veçanta për shtetet, të përgatitura nga ekspertët. Më shumë detaje në raportet e veçanta sipas vendeve.

\*Nuk ka përgjigje.

## Përfundime

- **Shqipëria:** Intervistat dhe diskutimet me përfaqësues të komunitetit të biznesit tregojnë se ata nuk shfaqin interes të veçantë për iniciativën, pavarësisht nga madhësia, pozicioni i tyre në treg dhe ndikimi i tyre. Në vend të kësaj, ata kryesisht e shohin iniciativën si një çështje politike dhe jo si diçka nga e cila të përfitojë komuniteti i biznesit. Gjithashtu, të huajt e punësuar në Shqipëri duhet të menaxhojnë personalisht të gjithë dokumentacionin dhe procesin për t'u kualifikuar për punësim, ndërkohë që kompania si punëdhënëse nuk ka asnjë barrë në këtë drejtim.
- **Bosnja dhe Hercegovina:** Një e treta e bizneseve shprehën interes për lëvizjen më të lehtë të punëtorëve në Ballkanin Perëndimor. Një e katërta tjetër e bizneseve shprehën interes për lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor, por janë kryesisht të interesuara për lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore me vendet e treta (kryesisht Kroacinë, Turqinë dhe Kinën). Të gjithë të tjerët, rreth dy të pestat e të intervistuarve ishin të fokusuar vetëm në fuqinë punëtore jashtë Ballkanit Perëndimor ose nuk ishin të interesuar për fuqinë punëtore të huaj. Midis atyre që janë të interesuar për lëvizje më të lehtë të punëtorëve në Ballkanin Perëndimor, kuptimi i tyre i përbashkët është se për të arritur këtë qëllim, BeH do të duhet të bëjë përrjashtime dhe të thjeshtojë procedurat administrative për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e qytetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor.
- **Kosova:** Mungesa e përgjigjeve nga bizneset kosovare për ndryshimet ligjore për qasje më të lehtë në fuqinë punëtore të huaj mund të tregojë se ata janë të pasigurt ose të ndarë për këtë çështje. Mund të nënkuptojë gjithashtu se ata janë më të fokusuar në operacionet e përditshme sesa në ndryshimet afatgjata të politikave. Kjo situatë tregon nevojën për komunikim më të mirë midis bizneseve dhe politikëbërësve për të diskutuar se si nga lehtësimi i kufizimeve të punës mund të përfitojnë bizneset.
- **Mali i Zi:** Duke marrë parasysh natyrën e ekonomisë së Malit të Zi, kryesisht e bazuar në punësimin sezonal të të huajve, punëdhënësit mendojnë se do të ishte e nevojshme futja e kategorisë së punëtorëve sezonalë të përhershëm në legjislacion, sipas shembullit të legjislacionit kroat. Kur bëhet fjalë për tregun e punës nga Ballkani Perëndimor, punëdhënësit kanë pushuar prej kohësh të gjejnë punëtorë në ato vende, por janë të orientuar kryesisht drejt tregjeve të largëta (Indi, Bangladesh, Nepal, Keni, Filipine, Moldavi). Në sektorin e ndërtimit preferohen punëtorë nga vendet e ish-BRSS: Uzbekistani dhe Taxhikistani, por është shumë e vështirë t'i gjesht. Për shembull, punëtorët nga Uzbekistani janë praktikisht të rezervuar për Britaninë e Madhe, pasi nuk kanë nevojë as për viza. Gjithashtu, filipinasit janë të dëshirueshëm si punonjës të turizmit dhe hotelierisë, por vendi i tyre e kontrollon shumë mirë largimin dhe punën e tyre në vende të tjera, që për Malin e Zi do të thotë një numër i reduktuar i punëtorëve në dispozicion. Problem shtesë është se në ato vende të largëta nuk ka zyra diplomatike-konsullore, kështu që shpesh përdoren ambasadat e vendeve të tjera për procedurat e nevojshme, gjë që ngadalëson edhe procesin e punësimit të të huajve. Prandaj, kur bëhet fjalë për legjislacionin, punëdhënësit nuk e konsiderojnë atë shumë kufizues, përveç në fushën e përcaktimit të statusit të punonjësit të përhershëm sezonal. Problemet kanë të bëjnë kryesisht me vetë procedurat, të cilat nganjëherë konsiderohen tepër burokratike, të pabarabarta dhe të paparashikueshme. Për shembull, në disa komuna, punëtorët kenianë janë të mirëpritur, ndërsa në të tjera jo.
- **Maqedonia e Veriut:** Rekomandohet rishikimi i legjislacionit në lidhje me të huajt dhe punësimin e të huajve, i cili mund të kërkojë ndryshime, të cilat do të lejojnë "përrjashtimin" e punëtorëve nga vendet pjesëmarrëse në nismën e Ballkanit të Hapur nga disa prej procedurave të nevojshme që

zbatohen për të gjithë të huajt e tjerë. Megjithatë, kjo procedurë preferenciale dhe e përshpejtuar duhet të përafrohet edhe me kërkesat e BE-së, në mënyrë që vendet të mos rishpikin procedura që nuk janë në përputhje me ligjin e BE-së dhe as që paraqesin një kërcënim sigurie apo ndonjë kërcënim tjetër. Si mundësi, u bë një propozim për të shqyrtuar një ligj të veçantë, që do të zbatohet për vendet e Ballkanit të Hapur, që do të rregullojë punësimin nga vendet e BP, por bizneset preferojnë që ai të mbulojë jo vetëm vendet e Ballkanit të Hapur, por të gjithë BP-në, veçanërisht për shkak të kërkesave (planet) për TPR (tregu i përbashkët rajonal) të BE-së.

- **Serbia:** Kuadri legjislativ në përgjithësi nuk është i favorshëm për akses të lirë në tregun e punës në rajon. Legjislacioni që rregullon aksesin në tregun e punës është përshkruar si i fragmentuar dhe kontradiktor, duke e bërë të vështirë zbatimin nga ana e kompanive. Kompanitë në sektorin e hotelerisë, ku Serbia ka një mungesë të dukshme të fuqisë punëtore, kanë shprehur pikëpamjet e tyre se vendi nuk është aq tërheqës për punëtorët nga Ballkani Perëndimor në krahasim me disa vende të tjera fqinje. Për shembull, Mali i Zi dhe Kroacia punësojnë shumicën e punëtorëve nga BP6 në këtë sektor, pasi Serbia nuk ofron përfitime që do të kompensoheshin nga kushte më të mira financiare për punëtorët sezonalë në krahasim me këto vende. Lidhur me protokollat e nënshkruara së fundmi për tregun e punës dhe skemat e identifikimit të qytetarëve, bizneset kanë kritikuar mungesën e transparencës në lidhje me këto protokolle. Në veçanti, protokollat e nënshkruara janë të disponueshme vetëm përmes faqes së internetit të qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe nuk janë të disponueshme në serbisht. Sa i përket rekomandimeve, bizneset e anketuara thanë se Qeveria duhet të ndryshojë rregulloren e saj për stimulimin e punësimit të punëtorëve të huaj. Me ligjet duhet të parashihen leje pune afatgjata dhe disa përfitime shtesë punësimi për punëtorët nga vendet e Ballkanit Perëndimor që të vendosin të vijnë për të punuar në vendin tonë.

## Qëndrimet në lidhje me përmirësimet e procedurave, personelit dhe pajisjeve

Ju paraqesim një përmbledhje të vlerësimit të ekspertëve në tabelën e mëposhtme<sup>3</sup>.

SHTETI	QËNDRIMET LIDHUR ME PROCEDURAT, PËRMIRËSIMET E PERSONELIT DHE PAJISJEVE	REKOMANDIME LIDHUR ME PËRMIRËSIMIN E PROCEDURAVE, PERSONELIT DHE PAJISJEVE
Shqipëria	<p>Nuk kërkohet staf shtesë dhe infrastrukturë e re.</p> <p>Stafi ekzistues duhet të trajnohet për të përdorur infrastrukturën dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve.</p> <p>Procedurat janë shpesh të gjera dhe të vështira, dhe një kalim i plotë në shërbimet online ishte i parakohshëm.</p> <p>Një problem tjetër i theksuar nga komuniteti i biznesit është informaliteti i tregut të punës, i cili në vetvete të kujton nevojën e disa ndërhyrjeve.</p> <p>Në veçanti, shërbimi elektronik nuk është efektiv për certifikatën e rezidencës tatimore: është i listuar në e-</p>	<p>Kërkohet njëfarë trajnimi për të përfaqësuar stafin në administratë.</p> <p>Procedurat mund të thjeshtohen dhe efikasiteti i tyre të përmirësohet.</p> <p>Nevojiten përmirësime në shërbimet elektronike tatimore.</p> <p>Prezantimi i një shërbimi aktiv të ndihmës për të sqaruar dhe shpjeguar përdoruesit se çfarë duhet të bëjë kur aplikacioni refuzohet, çfarë është e gabuar dhe çfarë duhet përmirësuar.</p>

<sup>3</sup>E njëjta.

	<p>Albania si shërbim, por nuk merrni kurrë përgjigje sepse aplikimi nuk arrin në organet tatimore.</p> <p>Për të qenë efektive, procedura duhet të plotësohet me dokumente në formë të printuar që duhet të dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.</p>	
Bosnja dhe Hercegovina	<p>Procedura përfshin shumë kërkesa për sa i përket dokumentacionit.</p> <p>Komplikime si rezultat të kërkesave të ndryshme nga dy entitetet dhe rrethi Brčko.</p> <p>Procesi, i cili duhet të zgjasë 30-45 ditë, në varësi të vendit në BeH, mund të zgjasë shumë më gjatë.</p> <p>Rrjeti i konsullatave të BeH nuk është i madh.</p> <p>BeH nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur.</p>	<p>Nuk është e nevojshme që të gjitha dokumentet të jenë në kopje origjinale</p> <p>Të shqyrtohet konsolidimi për të mundësuar akses në tregun e punës.</p> <p>Disa institucione parashikojnë një numër më të madh të nëpunësve civilë që punojnë në këto çështje, por këto vende pune shpesh nuk plotësohen.</p> <p>Në vitin 2023, në Ballkanin Perëndimor, BeH nuk ka konsullata në Tiranë dhe Prishtinë.</p> <p>BeH nuk i njeh dokumentet e Kosovës, përfshirë pasaportat.</p>
Kosova	<p>Trajnimi i stafit ekzistues lidhur me zbatimin e Ligjit për të Huajt.</p>	<p>Fuqizimi i administratës për të qenë më efektive dhe efikase.</p>
Mali i Zi	<p>Zbatimi i digjitalizimit, i cili tashmë është i paraparë në Ligj.</p> <p>Është e nevojshme të tregohet realisht numri i të papunëve në Mal të Zi.</p> <p>Krijimi i regjistrave elektronik për regjistrimin e të huajve do të lehtësonte shumë procedurën për punëdhënësit. Tani problemi buron nga dokumentacioni i gjerë.</p> <p>Standardizimi i procedurave të zyrtarëve për të huajt, në bashki të ndryshme, për të ofruar parashikueshmëri për punëdhënësit.</p>	<p>Me sistemin e teknologjisë së informacionit të regjistrimit, procedurat duhet të jenë më të shpejta dhe më të lehta. Por nevojitet edhe personel i mirëtrajnuar që do të punojë me sistemin, si dhe pajisje që do të siguronin një procedurë të shpejtë dhe efikase për aplikimin dhe regjistrimin e të huajve.</p>
Maqedonia e Veriut	<p>Procedurat për marrjen e lejeve të punës dhe miratimin duhet të dixhitalizohen plotësisht jo vetëm në departamentet që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët, por në departamentet ku kryhen operacione të brendshme, për të përshpejtuar dhe lehtësuar procesin. Kjo vlen jo vetëm për punëtorët nga vendet e iniciativës për Ballkanin e Hapur, por edhe për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përgjithësisht nga vendet e tjera.</p> <p>Sistemet administrative duhet të dixhitalizohen dhe të harmonizohen për</p>	<p>Digjitalizimi i procedurave me të gjitha vendet në përputhje me ligjin e BE-së.</p> <p>Zvogëlimi i kohës për kontrollë administrative dhe së paku respektimi i afateve të përcaktuara - janë vërejtur vonesa.</p> <p>Rinovimi i lejeve të punës ndonjëherë refuzohet pa arsye.</p> <p>Ka të ngjarë që ka mungesë të stafit, pajisjeve të digjitalizimit dhe koordinimit ndër-institucional që po shkakton vonesat.</p>

	<p>të koordinuar: agjencinë e punësimit, ministrinë e brendshme, administrimin e të ardhurave publike, sistemet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Aktualisht, proceset për marrjen e lejes së punës për punëtorët e huaj janë të ngadalta dhe shpesh zgjasin më shumë se koha e përcaktuar. Duhet shumë kohë për të marrë komente mbi kontrollet e sigurisë, veçanërisht nga vende të treta (jashtë BP dhe BE), kur ka nevojë për punë sezonale (fuqi punëtore me kualifikim të ulët) nga këto vende, çka mund të çojë në humbje të sezonit (për shembull, sektori i bujqësisë, sektori i ndërtimit).</p>	
Serbia	<p>Procedura komplekse që rregullojnë punësimin e fuqisë punëtore nga rajoni. Procesi i miratimit të vizës D kërkon një kohë të gjatë dhe i gjithë procesi është i pasigurt nga fillimi në fund.</p> <p>Sfida më e madhe është se punëtorët nga jashtë ndonjëherë thjesht “zhduken”, sepse nuk ekziston një mekanizëm që i detyron punëtorët të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale.</p> <p>Pagesa e punëtorëve të huaj mund të jetë komplekse.</p> <p>Në përgjithësi, punëdhënësit vendas mendojnë se nuk janë të informuar në mënyrë adekuate për procedurat dhe stimujt për punësimin e punëtorëve të huaj.</p>	<p>Ndryshimi i rregullores ekzistuese për të thjeshtuar punësimin e fuqisë punëtore nga rajoni. Për më tepër, agjencitë që punësojnë punëtorë nga jashtë duhet të jenë ligjërisht përgjegjëse për to.</p> <p>Përmirësimi i procesit të informimit për procedurat aktuale dhe stimujt lidhur me punësimin e punëtorëve nga jashtë.</p> <p>Përmirësimi i procesit të informimit në lidhje me aplikimin për shërbim në kuadër të nismës së BH dhe me kushtet e përgjithshme për punësimin e personave nga nisma e BH.</p>

Marrë nga raportet e veçanta të ekspertëve për vendet. Më shumë detaje në raportet e veçanta të vendeve.

## Përfundime

- **Shqipëria:** Bizneset në Shqipëri e konsiderojnë përgjithësisht administratën publike si tepër të paafte, joefektive dhe shumë të politizuar. Ekziston një mungesë besimi në aftësitë teknike të administratës publike (që në një farë mënyre inkurajohet nga zhvillimet e fundit në vend) dhe mungon vullneti në administratën publike për të kryer detyra të tilla pavarësisht numrit në rritje në mënyrë progresive të punonjësve në administratën publike (+180,000 në 2024). Në këtë drejtim, është e nevojshme të trajnohet në mënyrë të përshtatshme staf i ekzistues pasi të jenë ndryshuar procedurat (dhe mundësisht pasi të jetë rritur numri i aplikimeve për të siguruar staf të përshtatshëm për këtë qëllim).
- **Bosnja dhe Hercegovina:** Bizneset nuk janë mjaftueshëm të njohur me detajet e nismës Ballkani i Hapur. Prandaj, është e vështirë për ta të kuptojnë se si do të ndryshonin procedurat nëse BeH do të bëhej pjesë e nismës së BH. Por qëndrimi i tyre ndaj procedurave, personelit dhe pajisjeve aktuale në BeH ishte mjaft kritik. Ata besojnë se kërkojnë shumë dokumente për të aplikuar për leje pune për punëtorët nga jashtë. Për më tepër, tarifatat, procedurat dhe dokumentet e kërkuara ndryshojnë disi në pjesë të ndryshme të BeH. Kjo e ndërlikon procedurën për bizneset. Prezantimi i një

platforme në internet mund të zvogëlojë kohëzgjatjen e procesit. Për më tepër, rekomandimi i tyre ishte harmonizimi i tarifave, procedurave dhe dokumenteve të kërkuara në pjesë të ndryshme të BeH. Në të njëjtën kohë, ata sugjeruan që BeH të gjejë mënyra për të pranuar dokumente nga Kosova.

- **Kosova:** Personeli përgjegjës për procesin e punësimit të të huajve nuk zotëron aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të drejtuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive procedurat komplekse që rrjedhin nga kjo kategori punësimesh. Kjo mangësi mund të çojë në mungesë efikasiteti, gabime në dokumentacion, probleme të pajtueshmërisë ligjore si dhe komunikim jo të përshatshëm midis midis kompanisë dhe kandidatëve për punësim të huaj. Është e nevojshme të trajnohet stafi ekzistues i ngarkuar me procesin e punësimit të punëtorëve të huaj dhe të përmirësohet efikasiteti i procesit të punësimit të të huajve (përfshirë punëtorët nga BP6).
- **Mali i Zi:** Siç u theksua edhe më parë, punëdhënësit dëshirojnë të liberalizojnë tregun e punës, konkretisht Ligjin për të Huajt, në mënyrë që të gjejnë më lehtë punëtorët që u nevojiten. Por, ata nuk shohin shumë përfitim nga liberalizimi i zgjidhjes ligjore, aq sa shohin përfitim nga thjeshtimi i procedurave për punësimin e të huajve. Ata nuk bëjnë dallime ndërmjet punëtorëve potencialë nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të tjera të botës. Ata presin që digjitalizimi të përshpejtojë dhe thjeshtojë ndjeshëm procedurën për punësimin e të huajve. Të gjitha kërkesat për punë kryhen në tregje të largëta, përmes agjencive të punësimit që punojnë kryesisht për Kroacinë dhe Serbinë. Nga aty, problemi me mungesën e ambasadës malazeze në Indi është një kufizim, sepse ambasada serbe, mbështetjen e së cilës e shfrytëzon Mali i Zi, fillimisht do t'i kryejë procedurat për nevojat e veta dhe vetëm më pas për punëdhënësit malazezë, që pritet, por sigurisht që paraqet pengesë për punëdhënësit nga Mali i Zi. Theks i veçantë u vu në kërkesën për veprim të njëjtë gjatë procedimit të rasteve të të huajve nga ana e zyrtarëve, në të gjitha komunat në Mal të Zi, i cili duhet të zbatohet përmes disa udhëzimeve detyruese për interpretimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe trajnimit për ata zyrtarë.
- **Maqedonia e Veriut:** Komuniteti i biznesit deri më tani nuk ka raportuar për ndonjë pengesë në procedurë. Përfaqësuesit e biznesit besojnë se do të nevojitet një periudhë më e gjatë për të parë nëse do të shfaqen probleme të mundshme pasi të krijohen praktikatat aktuale të punësimit në periudhën e ardhshme. Në këtë moment, procedura konsiderohet e dobishme sepse do të shkurtojë kohën e pritjes dhe do të heqë disa dokumente dhe procedura si (sidomos) marrja e lejeve të punës. Për sa i përket protokollit dhe identifikimit elektronik, aktualisht konsiderohet të jetë funksional sepse procesi është shumë i shpejtë, pra i menjëhershëm. Në të njëjtën kohë, rekomandohet të shqyrtohet nëse ka përputhshmëri të përshtatshme dhe sistematike me institucionet dhe sistemet e tjera institucionale për të huajt në kuadër të iniciativës së BH. Domethënë, praktikisht, nëse sistemi i identifikimit me nismën Ballkani i Hapur do të jetë i zbatueshëm për punëdhënësit që të mund të "komunikojnë" me sistemin DHP për pagat dhe taksat, pastaj për kontributet për sigurime shoqërore dhe mundësinë praktike që punëtorët të përdorin shërbimet publike (harmonizimi i sistemeve të regjistrimit) dhe përfitimet (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore). Kjo i referohet nevojës së mundshme për të ndryshuar dhe përditësuar marrëveshjet dypalëshe të sigurimeve shoqërore. Duke qenë se digjitalizimi i sistemeve shtetërore nuk është në nivelin e kërkuar (integrimi i sistemit të DHP, sistemi shëndetësor, sistemi i sigurimeve shoqërore, agjencitë e punësimit, punët e brendshme, etj.) në vend, pritet që integrimi rajonal të ekspozohet ndaj sfidave.
- **Serbia:** Qasja e lirë në tregun rajonal të punës është e ndërlikuar nga procedurat rregullatore komplekse. Sipas tyre, pengesat lidhen kryesisht me institucionet (jo)funktionale qeveritare. Për shembull, procedura e miratimit të Vizës D zgjat më shumë dhe i gjithë procesi është i pasigurt nga fillimi në fund. Përveç kësaj, praktika tregon se pagesat nga punëdhënësit vendas për punëtorët nga jashtë janë më të vështira. Bankat ndonjëherë thjesht refuzojnë të hapin llogari për punëtorët

sezonalë, për shkak të qëndrimit të shkurtër. Kur bëhet fjalë për marrëveshjen në kuadër të nismës Ballkani i Hapur dhe protokolleve të nënshkruara, bizneset deklarojnë se procesi administrativ është shumë kompleks. Në përgjithësi, kontratat e nënshkruara nuk japin shumë informacion për vetë përdoruesit. Për shembull, nuk ka asnjë dokumentacion në portalin serb në lidhje me udhëzimet e punës për punëdhënësit. Për momentin përdoret një platformë digjitale për të cilën nuk ka shumë informacion për shërbimin, ndaj çdo aktivitet është i vështirë. Më konkretisht, pas regjistrimit, përdoruesi nuk merr asnjë informacion se çfarë të bëjë më pas.

